

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQERISE  
“PENINSULA DEVELOPMENT” Sh.p.k.**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” të ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Bisnesit” të ndryshuar, Unë i nenshkruari shpallim si me poshte vijon:

**FORMIMI I SHOQERISE  
Neni 1**

Formohet shoqeria e quajtur “PENINSULA DEVELOPMENT” Sh.p.k. (qe me poshte do te quhet “Shoqeria”) me ortake:

**Shoqëria “Generate” shpk.**, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 29.03.2016, me NUIS nr. L61529028E, me seli në adresën Njësia Bashkiake nr. 5, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Z. Andi Canaj, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr.personal: I10128046V,

**SELIA E SHOQERISE  
Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga "Dervish Bej Mitrovica", Pallati "Kristi- Co", nr. 6, kati përdhe, dyqani nr. 1. Tirane, Shqiperi. Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE  
Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar kohore, e cila fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE  
Neni 4**

Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar duke perfshire por pa u kufizuar si me poshte:

Objekti kryesor i Shoqerise eshte:

- a) Aktivitet në fushën e ndërtimit dhe investimeve e te sektoreve te ndryshem prodhues dhe te sherbimit.
- b) Aktivitet ne fushën e shërbimeve të konsulencës ligjore, financiare, audituese etj.
- c) Aktivitet ne fushen e ndermjetesim, nenkontraktim me te trete.

Për realizimin e këtij objekti Shoqëria do të kryej edhe veprimtari të tjera plotësuese të tilla si por pa u kufizuar :

- të kryej cdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme e të paluajtshme si dhenia me qera, huapendorje, uzufukt apo kalimi ne cfaredolloj menyre tjeter te lejuar nga ligji i te drejtes posedimore te pasurive te paluajtshme apo te drejtave reale te lidhura me to dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qera, të vendos pengje dhe barrë hipotekore, aktivite keto të konsideruara te dobishme apo të nevojshme për te arritur qëllimet e Shoqërisë
- Aktivitet importi - eksporti dhe tregtimi me pakice dhe shumice te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, blegtoral, brenda e dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise apo te treteve;
- Ndërtimin e çdo godine, qendra biznesi, hotele, bar-restorante, magazina, parking, komplekse turistike etj.
- Qirramarrjen, qirradhenien dhe leasing të pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, mallrave dhe produkteve për realizimin e qëllimit kryesor të shoqërisë.
- Të fitojë, direkt apo indirekt interesa ne shoqëri te tjera te cilat kanë nje objekt te ngjashëm me atë te Shoqërisë , në Shqipëri ose jashtë saj.
- **Gjithashtu per te realizuar objektin e qellimit e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tregtar, financiar që e vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.**

#### Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

### KAPITALI I SHOQERISE

#### Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise është 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë dhe i ndarë në 1 (nje) kuote me vlere nominale 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë . Cdo ortak ka të drejtën e votës.

Kontributi i ortakevut ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- **Shoqëria “Generate” shpk.**, zoteron 1 kuote e barabarte me 100 % te kapitalit fillestar te shoqerise, me vlere 50,000,000 (pesëdhjetë milion) lekë.

#### Neni 7

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

## **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmbanë ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Bisnesit (QKB).

### **Neni 9**

Ortaket e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

### **Neni 10**

Kuotat e çdo anetari përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e tij anetari i shoqërisë mund t'ua ofrojnë të tjerëve. Anetarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kuotave përpara personave të tjerë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Administratorit duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjti me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tjerë jashtë shoqërisë si dhe të dhenat e blerësit. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Edhe e drejta e përparësisë për nënshkrimin e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

E drejta e përparësisë për nënshkrimin e kuotave është në proporcion me kuotat që zoteron secili prej ortakeve në këtë shoqëri. Administratori pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh dhe në rast se ortaket do të blejnë këtë kuota, i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakeve të tjera për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me ose pa akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakeve.

### **Neni 11**

Emertimi i shoqërisë tregtare, forma ligjore e shoqërisë, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqërisë, emri i administratorit, duhet të jenë të përcaktuara në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri, nëpërmjet përdorimit të letres apo mjeteve elektronike, dhe që ju drejtohen të tjerëve. Shoqëria ka vullnet dhe saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

### **Neni 12**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortaket e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e

aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Administratori.

## **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

### **Neni 13**

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mund te thirret nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 5% te kapitalit te shoqerise. Anetaret duhet te njoftohen me shkrese ose nepermjet postes elektronike, jo me vonë se 7 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit te dites qe do te trajtohen ne mbledhje.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullise.

## **TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE**

### **Neni 14**

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

#### *1) Asambleja e Zakonshme:*

Mblidhet te pakten 1 here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Asambleja e zakonshme e ortakeve merr vendime te vlefshme kur jane prezent apo te perfaqesuar me prokure ortaket qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendos edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise ose nuk eshte lene ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme

#### *2) Asambleja e Jashtezakonshme:*

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do

te merren nga ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statutit.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me keto ceshtje;
- Vendos ne lidhje me çdo çeshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj .
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj .
- Si dhe çdo çeshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.

### **Neni 15**

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme te Ortakeve te cilat jane marre ne nje mbledhje te thirrur ne menyre te rregullt dhe konform kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjitha ortaket e tjere, edhe per ata qe nuk kane diskutuar ose nuk kane qene dakord.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesoje me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjeter me prokure te posacme.

### **Neni 16**

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

## **ADMINISTRIMI**

### **Neni 17**

Shoqeria administrohet nga administratori i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe 1 (një) vjecare me te drejte riperseritjeje. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga

specialistet perkates.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ua jep shprehimisht ortakeve.

Administrator i shoqerise eshte **Znj. Iris Erebara**, lindur ne 10.08.1988 ne Tiranë dhe banuese ne Tiranë, identifikuar me Letërnjoftim ID me nr identitetit I85810055O.

Administratori zgjidhet per nje periudhe 1 (një) vjecare me te drejte rizgjedhjeje.

#### **Neni 18**

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### **Neni 19**

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

### **MARREDHENIET E PUNES**

#### **Neni 20**

Maredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne

fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktrojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

### **Neni 21**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

## **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

### **Neni 22**

Kontroli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

## **BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 23**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhet detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

### **Neni 24**

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 25**

Ne rast se shoqeria priset per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emerone ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

## **LIBRAT E SHOQERISE**

### **Neni 26**

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve të organit administrativ
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve të eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vëlosur.

## **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 27**

Përsa është shprehur në këtë statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Bisnesit”, dhe rregullores së brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë siç është nxjerrë ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

## **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE “PENINSULA DEVELOPMENT” shpk**

Shoqëria “Generate” shpk

*ANDI CANAJ*



Tirane , me 15.09.2021